

# **STATUTI I Fondacionit “FAIK KONICA”**

## ***DISPOZITA TË PËRGJITHSHME***

### ***Neni 1***

Gjimnazi “Faik Konica”, është krijuar mbi bazën e ligjit nr.7952 datë 21/06/1995 dhe lejen e veçantë për hapjen e kësaj shkolle të dhënë me Vendimin e MASR nr.209 datë 19/06/2007.

### ***Neni 2***

Gjimnazi jopublike “Faik Konica” është person juridik i njohur me Vendimin nr.34536/1 datë 06/12/2006 të Gjykatës së rrethit Tiranë. Adresa e saj është :Rr “Besim Imami” Nr 50 Tiranë dhe nje pjese ne “Abdi Kazani Nr 5”

### ***Neni 3***

Gjimnazi jopublike “Faik Konica” është institucion mësimor – edukativ e shkencor, veprimtaria e së cilës rregullohet nga legjislacioni për arsimin e mesëm në RSH dhe në të njëjtën kohë është një institucion i pavarur ekonomik, veprimtaria e ta cilit rregullohet nga ligjet tregëtare të RSH.

#### *Neni 4*

Vendimet për funksionimin, drejtimin dhe tërë aktivitetin didaktiko-shkencor të gjimnazit "Faik Konica" merren nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj.

- a. Në strukturë të autoritetit dhe organit drejtues të gjimnazit janë; - Bordi drejtues i shkollës, organ me karakter këshillimor, struktura, kompetencat dhe mënyra e funksionimit të të cilit harrohet dhe miratohet në mbledhjen e parë të tij.
- b. Këshilli mesuesve, organ i cili ka për detyrë të hartojë dhe drejtojë tërë planet didaktiko-shkencore të veprimtarisë mësimore - edukative të shkollës, planet afatgjatë dhe afatshkurtër, objektivat dhe rrugët për ku synon të mbrijë shkolla si një model elitar, logon e saj, etj.

#### *Neni 5*

Vendimet që kanë të bëjnë me tarifat e shkollimit, punësimin, pagat, investimet, të ardhurat dhe shpenzimet e shkollës merren në çdo rast nga pronari i shoqërisë tregëtare ose administratori ngarkuar prej tij, pas konsultimeve me Bordin drejtues të gjimnazit.

Strukturat e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje ka të drejtë të propozojë, japë mendime dhe sugjerojë në mënyrë aktive për problemet ekonomiko-financiare.

#### *Neni 6*

Të drejtat e pronarit mund të ushtrohen edhe nga administratori i shoqërisë, i zgjedhur nga ortaku i vetëm, sipas përcaktimeve dhe kufijve të parashikuar nga ligji nr. 7638 datë 19.11.1992 – për shoqëritë tregëtare.

#### *Neni 7*

Gjimnazi "Faik Konica" ka për qëllim, mision dhe detyrë të përgatisë nxënës me një kulturë të përgjithshme, të atij niveli që t'i përgjigjen kushteve të konkurimit në të gjitha degët e shkencës në fakultetet e arsimit të lartë .

### *Neni 8*

Gjimnazi jopublik "Faik Konica" është shkollë jo politike, është kombëtare dhe laike.

### *Neni 9*

Mësimet në këtë gjimnaz kryhen në gjuhën shqipe ,dhe pjesa e projektit gjerman nje numer lendesh ne gjuhen gjermane.

### *Neni 10*

Mesuesit e gjimnazit jopublike "Faik Konica", gëzojnë liri akademike në procesin mësimor dhe në kërkimin shkencor, në kuptimin e ligjit "Për AML në Republikën e Shqipërisë".

### *Neni 11*

Kjo shkollë ka të drejtë të:

- Të miratojë planet dhe programet mësimore në përputhje me DN te MASR.
- Të miratojë tekstet në përdorim të nxënësve të saj (në radhën e teksteve alternative)
- Të përzgjedhë personalin mësimdhënës dhe atë administrative
- Të përzgjedhë nxënësit dhe nxisë regjistrimin e tyre pranë institucionit të saj çdo vit akademik mësimor
- Të krijojë lidhje me shkolla simotra brenda dhe jashtë vendit për nevojat e këmbimit të eksperiencave dhe rritjen e nivelit të saj shkencor në tërësi
- Të marrë pjesë në konkurse dhe aktivitetete konkurruese multilaterale me karakter kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

### ***Neni 12***

Kjo shkollë ka për detyrë:

- Të zhvillojë procesin mësimor dhe atë shkencor sipas standarteve të përcaktuara nga MASR, me qëllim që të përgatisë nxënës të niveli bashkëkohor elitar.
- Të punojë për të realizuar dhe aplikuar të gjitha dinamikat, zhvillimet dhe ndryshimet ligjore dhe didaktiko-shkencore që sjellin institucionet ligjvënëse brenda vendit dhe institucionet kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Të gjithë shpenzimet për realizimin e procesit mësimor dhe atij shkencor përballohen nga kjo shkollë.

## ***VEPRIMTARIA EKONOMIKE***

### ***Neni 13***

Gjimnazi "Faik Konica" është institucion privat me vetfinancim. Të ardhurat e tij krijohen nga tarifat e nxënësve dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

### ***Neni 14***

Gjimnazi ka të drejtë të pranojë ndihma financiare që lidhen me objektin dhe veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

### ***Neni 15***

Ai paguan rregullisht taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve. Pjesa e mbetur përbën fitimin e tij.

***Neni 16***

Veprimtaria ekonomike pasqyrohet në bilancet tremujore dhe vjetore të shkollës. Ajo mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

\* \* \*

***AUTORITETET DREJTUESE  
TË GJIMNAZIT "FAIK KONICA"***

***Neni 17***

Autoritetet drejtuese të veprimtarisë mësimdhënëse, didaktiko-shkencore, dhe disiplinore ,më karakter edukativo-kulturor brenda apo jashtë shkolle të gjimnazit "Faik Konica" janë:

- Drejtori i Shkollës
- Këshilli mesueseve
- Bordi

***Neni 18***

**Drejtori i gjimnazit** është autoriteti drejtues kryesor i këtij institucioni. Ai zgjidhet nga Bordi drejtues i gjimnazit (nga radhët e kandidaturave që ofron pronari....)  
Mardhëniet financiare të drejtorit me pronarin rregullohen dhe përcaktohen në kontratën e punës.  
Drejtori duhet të jetë një personalitet i njohur në fushën e mësimdhënies, i vlerësuar për nivelin dhe kontributet e tij të veçanta në këte fushe..

### *Neni 19*

Për të kryer më kompetencë, korektësi shkencore dhe nivel bashkëkohor detyrat e tij drejtuese të institucionit, **drejtori** ka këto kompetenca:

- a. Drejton tërë punën mësimore, hartimin e programeve, planeve mësimore, të punës, atë me karakter shkencor dhe veprimtaritë jashtëshkollore të gjimnazit
- b. Miraton, publikon dhe punon për njohjen e rregullores së gjimnazit, pasi ajo të jetë pëlqyer në parim nga bordi drejtues i shkollës.
- c. Ofron përpara bordit drejtues të gjimnazit kandidatura të përshtatshme mësuesish për praninë në stafin pedagogjik të gjimnazit sikurse mund të propozojë shkarkimin e tyre për motive dhe shkaqe që ai quan të arsyeshme.
- d. Organizon në mënyrë periodike mbledhjen e këshillit të mesuesve të gjimnazit dhe sipas rastit merr vendime për probleme të ecures së procesit mësimor apo të tjera me karakter disiplinor.
- e. Drejtori merr vendimet e tij për probleme të punës mësimore edukative në shkollë pas diskutimeve, debateve, sugjerimeve, propozimeve në këshillin e mesuesve.. Propozon veprimtari të tjera me karakter jashtëshkollor që mund dhe duhet të kryejë gjimnazi, të cilat do të ndihmonin në ecurinë dhe drejtë objektive elitare të gjimnazit.
- f. Cakton antarët e komisionit të MSH.
- g. Propozon, duke parashtruar argumentet me shkrim, përpara bordit drejtues për vërejtje, paralajmërim për përjashtim apo përjashtim nga shkolla të nxënësve që kanë manifestuar shkelje të rënda disiplinore dhe morale (në shkollë ose jashtë saj.)
- h. Mbas konsultave dhe sugjerimeve në Këshillin e mesuesve, i propozon bordit drejtues të gjimnazit ofrimin e "premiave-ve", shpërblime, apo stimuj moralë e materiale për nxënës apo familje nxënësish (në rast fatkeqsish apo....) që gjykon se duhen vlerësuar dhe shpërblyer si të tillë.

\* \* \*

## *Neni 20*

### **Këshilli mesuesve.**

Është organ kolegjal i cili vendos për probleme me karakter mësimor dhe ato shkencor të gjimnazit.

Këshilli shkencor përbëhet nga 8 veta. Kryetar i këshillit të mesuesve është drejtori i gjimnazit.

Këshilli i mesuesve ka këto kompetenca:

- Miraton planet mësimore të mesuesve të lëndëve
- Miraton programet mësimore të shkollës
- Miraton tekstet në përdorim të nxënësve
- Propozon pranë bordit drejtues duke dhënë argumentet konkrete strategjinë e zhvillimit dhe objeksionet ku pretendon të arrijë gjimnazi
- Propozon organizimin dhe pjesmarjen në veprimtari të ndryshme shkencore apo kulturore benda dhe jashtë vendit, të cilat do t'i shërbenin ngjitjes së gjimnazit drejt standarteve elitare.
- Mblidhet dhe diskuton në mënyrë periodike ecurinë e programit të shkollës duke sugjeruar dhe propozuar sipas rastit rrugë dhe mjete të reja për arritjen e pretendimeve maksimale.
- Shqyrton planet mësimorë
- Bën analiza tre, gjashtë dhe nëntëmujore duke konkluduar për ecurinë, të metat dhe detyrat që dalin për progreset e nevojshme të Gjimnazit.
- Sugjeron tematika dhe teknika të reja mësimdhënieje, aplikime të mundshme të arritjeve efektive bashkëkohore në organizimin dhe procesin mësimor, etj.
- Propozon shpërblime të ndryshme për stafin pedagogjik apo vërejtje për raste të shkeljeve apo veprimeve që vijnë ndesh me respektimin e dispozitave të këtij Statuti apo me normat e rregullores së gjimnazit.
- Propozon kualifikime të ndryshme shkencore të stafit mësimdhënës së gjimnazit me qëllim rrijen e nivelit shkencor e pedagogjik të tyre.

\* \* \*

## **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E NXËNËSVE**

### ***Neni 21***

Nxënësi e fiton statusin juridik që në momentin e regjistrimit të tij Gjimnazin jopublik "Faik Konica" dhe e humbet atë në çastin e dorëzimit të dëftesës, largimit të tij (për motive apo arsye.. ) apo përjashtimit të tij për ato raste që parashikohen në rregulloren e kësaj shkolle.

### ***Neni 22***

Nxënësi i gjimnazit "Faik Konica" ka të drejtë:

- të përfitojë nga procesi mësimor dhe të marrë dëftesën (diplomën) pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet e përcaktuara në planet dhe programet mësimore.
- Të përdorë të gjitha mjediset e shkollës të vëna në dispozicion për realizimin e programit mësimor
- Të organizohet në shoqata të ndryshme të nxënësve, me karakter kulturor, shkencor, sportive, argëtuese, jo politike sipas përcaktimeve në aktet ligjore.
- Të marrë pjesë në aktivitete me karakter kulturor, shkencor, sportiv dhe argëtues, të organizuara nga shkolla apo në bashkëpunim me institucione të tjera simotra, jashtë programit mësimor.
- Në kuadrin e demokracisë së brendëshme, të shfaqë dhe japë mendime për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor, duke sugjeruar mjete, forma dhe mënyra që do t'i shërbenin procesit të modernizimit të shkollës, programit dhe mësimdhënies.
- Të dëgjohen pretendimet e nxënësit në çdo rast kur nga hallkat e ngarkuara për marrjen e masave disiplinore mendohet apo është propozuar masë konkrete ndaj tij.
-



### *Neni 23*

Nxënësi i Gjimnazit "Faik Konica" është i detyruar:

- Të respektojë disiplinën e formatuar në rregulloren e këtij gjimnazi;
- Të paraqitet në kohë për fillimin normal të ditës mësimore dhe plotësimin e kërkesave formale disiplinore në tërësi
- Respektimin e rregullave të vendosura për jetën brenda ambjenteve shkollore dhe klasës mësimore
- Respektimin e normave të etikës dhe mirsëlljes, respektimin e më të rriturve dhe të bashkënxënësve
- Të ushqejë në mënyrë periodike kërkesat ndaj vetes dhe të tjerëve për rritjen e nivelit kulturor, shkencor, të dijeve në tërësi dhe të kërkojë në mënyrë analoge këto edhe nga bashkënxënësit e tjerë.
- Të rrisë dhe forcojë frymën e dashurisë, miqësisë, respektin e ndërsjelltë dhe kolektivitetit.
- Të zhvillojë me kurajë dhe edukatë frymën e kritikës për probleme që e gjykon se i shërbejnë progresit dhe prosperitetit, mësimi dhe ecurisë së bashkënxënësve dhe gjimnazit në tërësi.

\* \* \*

### *Neni 24*

Personeli i gjimnazit "Faik Konica" përbëhet nga:

- a. mësuesit (personeli mësimdhënës)
- b. personeli administrativ
- c. personeli i shërbimeve ndihmëse

Pas miratimit të kërkesës së tyre për punësim nënshkruajnë kontratën që lidhet mes drejtorit të gjimnazit dhe të punësuarit dhe miratohet prej administratorit të shoqërisë.

Kontratat lidhen me afat nga një deri në pesë vjet.

Kontratat e punës për të gjithë personelin lidhet dhe zgjidhet duke respektuar legjislacionin shqiptar në tërësi dhe atë të punës në veçanti.

*Neni 25*

**KOHA E PUNËS DHE PUSHIMEVE**

Koha e punës e personelit të gjimnazit është 8 orë. Kjo kohë për nevojat e punës kualifikuese pedagogjike dhe shkencore të personelit mësimdhënës mund të jetë edhe më e shkurtër.

*Neni 26*

Pushimet vjetore të personelit në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 220 dt.24.05.1994, janë 12 plus 36 ditë pushimi plotësuese.

Probleme të tjera që lidhen me kohën e punës dhe pushimet përcaktohen në kontratën e punës që hartohet në bazë të legjislacionit në fuqi.

*Neni 27*

**NORMA, NGARKESA MËSIMORE DHE KUALIFIKIMET**

Mësuesit janë të detyruar të marrin dhe realizojnë normën mësimore shkencore konform kritereve të përcaktuara në Ligjin mbi arsimin e mesëm.

*Neni 28*

Gradat dhe titujt shkencorë, vlerësimet kombëtare për kontributet në fushën e mësimdhënies dhe rezultatet në punën për ngritjen e Gjimnazit "Faik Konica" në nivelin e një shkolle elitare kombëtare do të lidhen drejtpërdrejt me pagën e mësuesit.

***Neni 29***

Personeli mësimdhënës gëzon të drejtën e kualifikiumit të tij shkencor sipas kritereve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 786 datë 17. 12. 1998 dhe aktet e tjera nënligjore.

***Neni 30***

Kualifikim shkencor i personelit mësimdhënës inkurajohet dhe i krijohen lehtësitë e mundëshme kushte dhe kritere këto që përcaktohen në ligjet për AML dhe që duhet të reflektohen edhe në kontratën e punës.

***Neni 31***

***VULA, STEMA DHE LOGO E GJIMNAZIT  
“FAIK KONICA”***

**VULA**

Gjimnazi jopublik “Faik Konica” ka vulën e tij ku shkruhen fjalët :Gjimnazi i Tiranës “Faik Konica” dhe brenda rrethit të vulës është e gdhendur logo e shkolles.

**STEMA**

Gjimnazi “Faik Konica ka stemën e vet që përfaqësohet nga një libër i hapur, një pendë shkrimi përmbi të, gjysma në ngjyrë të kuqe dhe gjysma në ngjyrë të zezë.

**LOGO**

Logo e shpallur publikisht, e cila do të jetë simboli i vetë gjimnazit, dhe mesazhi që do të përfaqësojë dhe udhëheqë lëvizjen, objektivin e tij drejt një shkolle elitare do të jetë: “Synojmë vëndin e parë.....”

***Neni 32***

Bashkangjitur statutit përpilohet dhe qëndron rregullorja, një akt i cili hartohet dhe ndryshohet nga Këshilli mesuesve me pëlqimin e Bordit drejtues të gjimnazit.

*Me pëlqimin e Bordit të gjimnazit “Faik Konica”*

*M I R A T O H E T  
Drejtori i gjimnazit “Faik Konica”*

**RREGULLORE E GJIMNAZIT  
“FAIK KONICA”**

**PARIME TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Rregullore e Gjimnazit jo publik “Faik Konica”, mbështetet në Ligjin nr.7952 datë 21/06/1995 për arsimin e mesëm në Republikën e Shqipërisë dhe në lejen e posaçme për hapjen e shkollës të dhënë me Vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve nr.209 datë 19/06/2007 si dhe në Statutin e kësaj shkolle.

**Neni 2**

Kjo Rregullore i bashkangjitet Statutit të Gjimnazit “Faik Konica” dhe shtrin, rregullon veprimtarinë e saj në tërë strukturat përbërëse të këtij institucioni.

\* \* \*

## ***STRUKTURA ORGANIZATIVE***

### **Neni 3**

Struktura organizative e këtij institucioni është:

- a. Autoriteti drejtues
  - 1. Drejtori
  - 2. Përgjegjësit e departamenteve lëndore
  
- b. Organet drejtuese
  - 1. Bordi drejtues i gjimnazit
  - 2. Këshilli mesuesve të gjimnazit
  
- c. Administrata:
  - 1. Sekretaria mësimore
  - 2. Financa
  - 3. Palestra e forces dhe aerobise.

### **Neni 4**

#### ***DREJTORI***

Drejtori është autoriteti më i lartë i gjimnazit. Kompetencat e tij janë përcaktuar në Statut.

### **Neni 5**

#### ***BORDI DREJTUES***

Bordi drejtues është organ kolegjal me karakter këshillimor. Ai ka për detyrë të japë mendimin pëlqimin apo mospëlqimin e tij për veprimtarinë, objektivat, misionin si dhe vendime që ndikojnë në problemet e ecurisë së Shkollës, dinamikës, disiplinës dhe në tërësi progresit apo pengesave dhe problemeve që dalin, me qëllim kapërcimin, evitimin e tyre dhe orientimin e Shkollës drejt qëllimit si institucion elitar.

Bordi mbledhet jo më pak se një herë në tre muaj . Për raste dhe çështje të veçanta edhe më shpesh.

Kryetari i këtij bordi zgjidhet nga antarët e tij me votim të hapur, me shumicë votash.

Qëndrimi në këtë funksion është deri në një vit dhe funksioni ndjek parimin e rotacionit.

## **Neni 6**

### ***KËSHILLI MESUESVE.***

Këshilli mesuesve është organ kolegjal.

Ai përbëhet nga personeli mësimdhënës dhe drejtohet nga Drejtori i gjimnazit.

Këshilli mbledhet në mënyrë periodike jo më pak se një herë në muaj.

Këshilli mesuesve është organi që diskuton dhe vendos për probleme me karakter mësimor, shkencor, kulturor dhe disiplinor të gjimnazit.

Përpara se vendimet e marra prej tij të zbatohen, për ato çështje që parashikohen si të domosdoshme për t'u këshilluar, i kalohen Bordit drejtues dhe mandej, vendimet publikohen për t'u zbatuar.

Këshilli shkencor përbëhet nga 8 veta. Drejtori, përgjegjësat e departamenteve dhe nxënës të talentuar. Kryetar i keshillit të mesuesve dhe atij shkencor është drejtori i gjimnazit.

## **Neni 7**

### **MËSUESIT**

Mësuesi i gjimnazit është hallka bazë e mësimdhënies. Ai ka për mision dhe detyrë të përcjellë tek nxënësit dije sa më të gjëra, të sakta dhe korrekte në pikpamje shkencore, kulturore e morale.

### **DETYRAT FUNKSIONALE TË MËSUESIT**

Mësuesi ka për detyrë:

- a. Të respektojë dhe realizojë, për realizimin e procesit mësimor, ngarkesën mesatare prej 18- 20 orë në javë.
- b. Për plotësimin dhe realizimin e procesit mësimor, mësuesi është i detyruar të respektojë disiplinën e orarit të mësimit, duke kërkuar me korrektësi këtë gjë edhe prej nxënësve.
- c. Mësuesi është objekt dhe subjekt i disiplinës së ndërgjegjshme të shkollës.
- d. Në fillim të çdo viti mësimor mësuesi është i detyruar të dorëzojë pranë Drejtorit të gjimnazit për miratim planin mësimor dhe atë edukativ.
- e. Pas miratimit, ky plan është i detyrueshëm për zbatim në procesin mësimor.
- f. Bashkë me planin mësimor, mësuesi është i detyruar të hartojë ditarin e tij (planin ditor të mësimdhënies).
- g. Mësuesi i gjimnazit është përgjegjës gjithashtu edhe për edukimin dhe formimin korrekt të nxënësve më normat dhe sjelljet e shëndosha morale.
- h. Për nevojat e një pune aktive dhe të gjithanshme me nxënësit, mësuesi duhet të punojë dhe këmbëjë në mënyrë aktive mendime me prindërit e nxënësve, në takimet periodike me ta, duke sugjeruar dhe këmbyer mendime konkrete për subjektet në fjalë.
- i. Jashtë dhe përveç procesit mësimor, mësuesi duhet të organizojë edhe takime në grup apo me klasa të caktuara, me tematika dhe objeksione specifike që do t'i shërbenin njohjes së gjendjes, problematikës dhe nevojave të nxënësve.
- j. Të përgatisë programin semestral dhe vjetor, në përputhje me udhëzimet dhe programet mësimore të miratuara nga MAS.
- k. Të jetë i përgatitur çdo ditë me ditarin përkatës, i cili të jetë analitik, racional dhe të pasqyrojë teknologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, punën në grupe, punën individuale, të mësuarit aktiv e krijues etj.
- l. Të përgatitet për cdo orë mësimi për demonstrime me mjete konkrete, kasete , disketa, CD, tabela etj.
- m. Të përdoren dhe shfrytëzohen kompjuterat, tabelat elektronike, projektori etj. në ndihmë të mësimdhënies.
- n. Të jetë i mirëinformuar me të gjitha metodikat e reja , materialet ndihmëse për mësuesin, literaturën bashkëkohore, shkencore e pedagogjike. (cdo muaj cfarë është lexuar)
- o. Mësuesi është i detyruar të organizojë konsultime me nxënësit pas orëve të mësimit si dhe në pushimet e gjata.

- p. Përgjigjet për mirëmbajtjen e orendive, pajisjeve të klasës e laboratoreve (kur nxënësi i klasës së tij dëmton). Nëse dëmtohet diçka nga nxënësi i klasës së tij kujdestare, ai duhet të raportojë në sekretari menjëherë.
- q. Mësuesi brenda orës së mësimit përgjigjet për pjesmarrjen e nxënësve në mësime, si dhe lajmëron menjëherë në sekretari nëse ndonjë nxënës është larguar nga ora e mësimit.
- r. Ndërton marrdhënie partneriteti me prindin. Takimet me prindin duhet të jenë jo vetëm raportime, konstatime, por diskutime për problem, shqetësime etj. të parapërgatitura.
- s. Takimet me prindërit duhet të planifikohen : nje herë në dy muaj me të gjithë prindërit e klases. konferenca mësues – prind me problematikë të paracaktuar (një herë në dy muaj); komunikime të përditshme me telefon, e-mail, letra etj.
- t. Një herë në tre muaj mësuesi harton një karakteristikë për secilin nxënës, e cila përmban ecurinë e nxënësit në mësime, qëndrimet e tij, sjelljet dhe problem të ndryshme të edukimit etj.
- u. Mësuesi detyrimisht duhet të marrë pjesë në mbledhjet e këshillave pedagogjike, duke u parapërgatitur për diskutime profesionale.
- v. Mësuesi që mungon 5 ditë pa arsye, i prishet kontrata dhe largohet nga puna. (arsyet mund të jenë shëndetsore, familjare).
- w. Për thyerje të rregullave e moszbatim të akteve normative të MAS, mësuesi i nënshtrohet masave administrative – disiplinore si qortim, vajtje, vajtje me paralajmërim për pushim nga puna, pushim nga puna.
- x. Mësuesi ka të gjitha hapësirat e nevojshme për të shprehur mendimin e tij për të gjitha problemet mësimore educative në shkollë.
- y. Mësuesi respekton kushtet e kontratës, ashtu sikurse kërkon respektimin e këtyre kushteve nga pala tjetër.

## MËSUESI DEZHURN

Do të përgjigjet për:

- a. Hyrjen, daljen e rregullt të nxënësve
- b. Rënien e ziles në orët e caktuara
- c. Shpërndarjen dhe grumbullimin e rregjistrave
- d. Pastrimin dhe disiplinën në shkollë



- e. Ndjekjen e frekuentimit dhe raportimin në drejtori

### **MËSUESI KUJDESTAR**

Ka këto detyra:

- a. Të ndjekë përparimin , rregullin , disiplinën e nxënësve të klasës së tij
- b. Të ndjekë cdo ditë dhe cdo orë mësimi frekuentimin e nxënësve të klasës së tij, duke vënë në dijeni sekretarinë e shkollës për cdo mungesë qoftë ditore , qoftë një orëshe.
- c. Të hartojë në bashkëpunim me mësuesit e edukimit fizik, muzikës ,dansit dhe mësuesve te disiplinave shkencore planin e veprimtarive jashtëkurrikulare.
- d. Të organizojë takimet me prindërit.

### **VLERËSIM I PUNËS SË MËSUESIT**

Vlerësimi i punës së mësuesit është vjetor dhe ndërtohet mbi bazën e treguesve të mëposhtëm:

- a. Niveli i përvetësimit të njohurive nga ana e nxënësve ( teste me shkrim dhe me gojë, realizim standartesh) në lëndën që ai spjeron
- b. Mardhëniet e krijuara në klasë, klima që mbizotëron në mardhëniet me nxënësit dhe prindërit (vëzhgime, monitorime, anketime me nxënësit dhe prindërit)
- c. Efikasiteti i mardhënieve mësues – prindër (anketime, intervista, monitorime
- d. Kërkesa e mësuesit (rezultatet e nxënësve, vëzhgime të sistemit të punës së mësuesve, anketime)
- e. Rezultatet e nxënësve të tyre në konkurse , olimpiada
- f. Zbatimi i rregullores
- g. Përkushtimi ndaj problemeve në shkollë

- h. Risitë që sjell në sistemin e punës së tij
- i. Figura morale e mësuesit

### **Neni 8**

#### ***AFATI I STUDIMEVE NË GJIMNAZ***

Afati i studimeve të gjimnazit është 3 vjet.

### **Neni 9**

#### ***MËSIMI***

Format e punës mësimore janë:

- Mësimdhënia, leksioni, referimi i mësuesit
- Provimet periodike,
- Ushtrimet
- Punët laoratorike
- Detyrat e shtëpisë
- Punët e pavarura
- Esetë
- Konkurset
- Provimet e maturës (formimit)
- Mësimet treguese
- Modulet
- Projektet

### **Neni 10**

#### ***KONTROLLI I DIJEVE***

Kontrolli i dijeve të përfituara në procesin mësimor bëhet me gojë dhe me shkrim.

Në çdo rast dijet e nxënësit kontrollohen nga kontaktet e drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme të mësuesit me nxënësin dhe bashkëbisedimet periodike.

### **Neni 11**

#### ***VLERËSIMI SISTEMI I NOTAVE***

Gjimnazi "Faik Konica", për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të dijeve prej nxënësve aplikon sistemin e dhjetë notave.

Notat nga pesë e lart janë kaluese.

Mësuesi në ushtrimin e kontrollit të tij, gjatë vitit mësimor, është i lirë të aplikojë sisteme të ndryshme vlerësimi, por në fund praktikat e tij të vlerësimit duhet t'i kthejë në notë.

### **Neni 12**

#### ***SHKOLLA DHE FAMILJA***

Shkolla mban kontakte dhe mardhënie të afërta, jo më pak se një herë në dy muaj me prindërit e nxënësve

Mardhëniet e shkollës me familjet e nxënësve të saj konsiderohen si një hallkë e rëndësishme e mbarvajtjes dhe rezultateve përherë e më progressive.

Kontaktet periodike dhe këmbimi reciprok i mendimeve për ecurinë e nxënësve në procesin mësimor, jetën dhe aktivitetin jashtëshkollor, shqetësimet, vështirësitë, dëshirat, prirjet, etj ofrojnë mundësitë për rezultate përherë në rritje dhe maksimale.

### **Neni 13**

Në përfundim të studimeve të gjimnazit zhvillohet Provimi i Maturës.

Gjimnazi "Faik Konica" është i detyruar të aplikojë dhe respektojë të gjitha kërkesat, kriteret dhe sistemet e përcaktuara nga MASR për Provimin e Maturës.

#### **Neni 14**

##### ***KLASA DHE GRUPI***

Mësimi zhvillohet në klasa, në grupe jo më shumë se \_20 vetë.  
Mësuesi mund të aplikojë dhe organizojë mësimet në grupe më të vegjël dhe punë të diferencuar për të realizuar rritjen e nivelit dhe formimit të nxënësve në shkallë përherë më të lartë.

#### **Neni 15**

##### ***NDARJA NË KLASA DHE REGJISTRI***

Ndarja e nxënësve në klasa shënohet që në fillim të vitit, në regjistrat standarte të notave.

Regjistri është një dokument zyrtar, i cili ka numrin e tij në protokollin e shkollës dhe shërben për të vërtetëuar zhvillimin e orës së mësimi si dhe vlerësimet periodike të nxënësve në lëndët mësimore që ka programi mësimor vjetor.

Askush nuk ka të drejtë të bëjë shënime dhe korigjime mbi regjistrin.

Në përfundim të vitit shkollor, regjistri ruhet në fondin e dokumenteve arkivore të Gjimnazit.

## **Neni 16**

### ***DITËT E MËSIMIT***

Gjimnazi "Faik Konica" zhvillon veprimtarinë e tij mësimore rregullisht, sipas kriterëve të parashtruara në Ligjin mbi AML nga dita e hënë deri ditën e premte.

## **Neni 17**

### ***ORARI I MËSIMIT***

- Mësimi fillon në orën 9.00 të çdo dite.
- Ora mësimore (akademike) është 45 minuta.
- Dita mësimore duhet të jetë jo më shumë se shtatë orë dhe përfundon në orën 14.10.
- Në përfundim të çdo ore 45 minutshe duhet të ketë jo më pak se 5 minuta pushim.
- Orari mësimor për çdo vit dhe klasë mësimore hartohet nga mësuesit, duke ndjekur kriteret pedagogjike, ngarkesën e nevojshme kohore dhe lëndore.
- Zbardhja e orarit dhe auditori (klasa) e zhvillimit të mësimit përcaktohen nga sekretaria mësimore.
- Orari duhet të bëhet publik dhe të afishohet në ambjentet e përbashkëta të nxënësve.
- Respektimi i orarit dhe auditorit është i detyrueshëm për të gjithë, nxënësit dhe mësuesit.

(Këtu mund të vihet konkretisht orari....)

## Neni 18

### ***TË DREJTAT DHE DETYRIMET E NXËNËSIT***

Nxënësit e Gjimnazit "Faik Konica" kanë të drejtë:

- Të përfitojnë maksimalisht dije, kulturë dhe formim shkencor nga procesi mësimor,
- Të përdorë dhe shfrytëzojnë maksimalisht mjediset e Gjimnazit për realizimin dhe përvetësimin maksimal të programit mësimor,
- Të marrë pjesë në veprimtari brenda dhe jashtë shkollore me karakter kulturor, artistik, sportiv, konkurse, debate kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat i shërbejnë ngritjes së nivelit dhe formimit të tij në stade elitare.
- Të organizohet në shoqata jopolitike, veprimtaritë e të cilave ndihmojnë nxënësin por edhe shoqërinë tonë në rrugën e civilizimit, modernitetit dhe prosperitetit.
- Të shfaqë mendime dhe të ofrojë sugjerime për përmirësimin e procesit mësimor dhe asimilimin sa më të thellë e të gjërë të dijeve.
- Të kërkojë nga veltja dhe shokët respektimin e kërkesave të disiplinës, të mirmbajtjes së ambjenteve, higjenës dhe në tërësi të një jete shkollore të qytetëruar.
- Të nxisë dhe pranojë frymën e kritikës dhe autokritikës, të miqësisë dhe solidaritetit, të ndihmës reciproke dhe sakrificës.
- Të njohë me hollësi rregullar e procesit mësimor dhe detyrimet që dalin prej tij.
- Të njohë rregullat e Statutit të Gjimnazit dhe detyrimet që lindin prej tij.
- Të frekuentojë rregullisht shkollën, duke e konsideruar këtë si detyrë dhe detyrim.

## Neni 19

### STIMUJT PËR NXËNËSIT ELITARË

Nxënësi që:

- arrin të pozicionet në 2 vëndet e para në konkurset e olimpiadat me karakter lokal stimulohen me uljen e pagesës vjetore të shkollës deri 30 %;
- arrin të pozicionohet në 2 vëndet e para në konkurset e olimpiadat me karakter kombëtar stimulohet me uljen e pagesës vjetore deri në 50 %;
- arin të pozicionohet në 10 vëndet e para në konkurset apo olimpiadat me karakter ndërkombëtar stimulohet me frekuentim të shkollës pa pagesë.

## Neni 20

### DETYRIMET E NXËNËSIT DHE MASAT DISIPLINORE

Në përputhje me aktete normative në fuqi, nxënësi është i detyruar;

- Të respektojë orarin e mësimëve dhe kërkesat për një disiplinë të ndërgjegjshme në shkollë dhe jashtë saj.
- Të mbajë përgjegjesi për shkeljen e rregullave të gjimnazit, dhe në rastet e dëmeve materiale të shkaktuara të c`dëmtojë ato në masën që përcakton drejtori ,financa dhe administrator.
- Për rastet e shkelljes së rregullave të gjimnazit si dhe për veprime të tjera që çënojnë normat shoqërore, etike, morale, si:
  1. cënimi i funksionimit normal të procesit të mësimdhënies,
  2. i dinjitetit të mësimdhënësit,
  3. i punonjësve të tjerë të shkollës,

4. kopjimi në provime,
5. falsifikimi i dokumenteve,
6. akte rrugaçërie,
7. vjedhje të vogla,
8. përdorim celulari

kur ato nuk përmbajnë elementë të veprës penale, Drejtori dhe këshilli mesueseve ka të drejtë që ndaj këtij nxënësi të kërkojë marrjen e këtyre masave disiplinore:

### **Neni 21**

#### **MASAT PËR MOSRESPEKTIM TË DISIPLINËS MËSIMORE**

Nxënësi që:

- a. bën 30 mungesa pa arsye qortohet nga drejtorja, si dhe njoftohet prindi
- b. bën 35 mungesa pa arsye paralajmërohet për përjashtim nga shkolla
- c. bën 45 mungesa pa arsye përjashtohet nga shkolla
- d. mungon mbi 30 % të orëve semestrare në një lëndë është i detyruar të japë provim në këtë lëndë, në të kundërt ai klasifikohet mbetës në këtë lëndë.
- e. mungon 30 % të orëve semestrare në një lëndë, klasifikohet mbetës në këtë lëndë.
- f. mungon mbi 30 % të orëve mësimore vjetore, klasifikohet mbetës në lenden perkatese.

### **Neni 22**

#### **LLOJET E MASAVE DISIPLINORE**



Në rastet kur vërtetohet se nxënësi ka kryer shkelje të natyrave që përmenden në nenin 18 të kësaj rregulloreje, ndaj tij mund të merren këto lloj masash disiplinore:

- Qortim
- Vërejtje me shkrim
- Thyerje e notës së sjelljes
- Përgjashtim disiplinor i përkohshëm nga Shkolla
- Përgjashtim përgjithmonë nga shkolla.

Masat disiplinore ndaj nxënësit që ka kryer një nga shkeljet e parashikuara në dispozitat e mësipërme, merren mbas diskutimit në *këshillin e etikes*, pastaj kalojnë në *këshillin e disziplines* dhe me vendimin kolegjal të tij jepet masa.

Për raste të vecanta dhe në rrethana specifike që drejtori i gjimnazit i konsideron si të tilla, ky i fundit mund të vendosë personalisht për llojin dhe natyrën e masës disiplinore.

Në rastet kur Këshilli mesuesve ka rezerva apo e gjykon si jo objektive vendimin konkret të drejtorit, mund t'i drejtohet për rishqyrtim rastit në Bord..

### **Neni 23**

#### ***DIPLOMIMI***

Në përfundim të ciklit të plotë tre vjeçar të mësimave si dhe të vlerësimit në provimin e MSH, nxënësit e gjimnazit "Faik Konica" kanë të drejtë të pajisen me Certificate të matures shtetërore dhe diploma nga QSHA. Certificate e matures firmoset nga Drejtori i Shkollës....

Mbi firmën e Drejtorit vendoset vula e Gjimnazit "Faik Konica"

### **Neni 24**

Dorëzimi i bëhet me ceremoni.

Për nxënësit që kanë përfunduar ciklin e plotë mësimor të gjimnazit me rezultate të shkëlqyera, akordohen stimuj moralë dhe materiale.

("Nxënës i Shkëlqyer", "Medalje e Artë"....)

Diploma e matures tërhiqet personalisht prej nxënësit kundrejt nënshkrimit personal dhe evidentohet në një regjistër të posaçëm (të Amzës)

Nëse prania e nxënësit (të diplomuarit) është e pamundur për arsye objektive, certifikaten e diplomën mund ta tërheqë vetëm një nga pjestarët e familjes së tij, i pajisur më prokurë të posaçme duke paraqitur kartën e identitetit të tij.

Nëse humbet diploma e maturësose certifikata e notave, gjimnazi mund të lëshojë vetëm vertetim notash me foto.

Lista e notave nënshkruhet vetëm nga drejtori i gjimnazit dhe vërtetohet nga vula e gjimnazit "Faik Konica".

## **Neni 25**

Rregullorja e shkollës pas hartimit të saj dhe diskutimit në bordin drejtues i kalohet për miratim këshillit të mesueseve dhe siglim drejtorit të gjimnazit.

Ripunuar .Tiranë, më 13. 09. 2018